



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), nenit 12 të Rregullores MF-Nr.-04/2017 dt. 13.06.2017, mbi kriteret standarde dhe proceduar e financimit publik të OJQ-ve , rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, si dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, nxjerr këtë

V E N D I M

I.

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekt propozime të Klubeve, organizatave jo-qeveritare, Individëve dhe Bizneseve në fushat: *Rini dhe Sport*.

II.

- a) Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe të zbatohet rregullorja për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;
- b) Mbështetja financiare publike për projekt propozimet e OJQ-ve, Klubeve, Individëve dhe Bizneseve do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Prishtinës.
- c) Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 600,000€ (Euro).

III.

Mjetet e përmendura në nenin 2 pika c, do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, Klubeve, Individëve dhe Bizneseve sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV.

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
 - a) Teksti i thirrjes publike;
 - b) Udhëzimet për aplikantët;
 - c) Formularët e aplikimit (që gjenden në aplikacionin online);
 - d) Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve (që gjenden në aplikacionin online);
 - e) Format për raportimin e zbatimit të projektit;
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - a) Forma e përshkrimit të programit apo projektit (që gjenden në aplikacionin online);
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - a) Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit;
 - b) Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
 - c) Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit;

V.

Thirrje publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në web -faqe e internetit të Komunës së Prishtinës <http://krs.prishtinaonline.com/>.

VI.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, si dhe rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VII.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve.
2. Komuna e Prishtinës do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Rini dhe Sport, Komuna e Prishtinës.

VIII.

Ky vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit.

U dorëzohet:

- Zyrës për marrëdhënie me publikun,
- Qendrës për shërbim me qytetarë dhe
- Në dosje
- DS

Kryetari i Komunës
Shpend Ahmeti

